



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 40.2 "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 40.2, "dh" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenit 8 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve të ndarjes së subvencioneve entiteteve publike dhe jo publike dhe ndihmës momentale në të holla 01Nr 37-2/11 të datës 24.02.2011, si dhe kërkesës së OVL-së së UÇK-së të dt. 07.06.2012, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e vetë të mbajtur më **28.06.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga fondi për subvencione në llogari të Organizatës së Veteranëve të luftës së UÇK-së, dega në Vushtrri, në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro) për shënimin e ditës së formimit të Brigadës së UÇK-së – Zona Operative e Shalës (28.06.2012).

Neni 2

Obligohet Zyra e Kryetarit të Komunës që të lidhë marrëveshje me përfituesin e këtyre mjeteve, i cili do të hartoj raport për mjetet e shpenzuara në shumën e cekur si në nenin paraprak.

Neni 3

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që nga viti i ardhshëm (2013) të përfshijë në planin buxhetor të komunës mjete në shumë prej 5.000 € për shënimin e kësaj date, duke qenë se ky manifestim ka karakter tradicional dhe do të shënohet në çdo 28 qershor.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **28.06.2012**, pas shqyrtimit të Qarkores Buxhetore të Komunës së Vushtrrisë 01/2013 dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë rëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ëpet në diskutim publik Qarkorja Buxhetore e Komunës së Vushtrrisë 01/2013.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 29.06.2012 dhe zgjatë deri më 27.08.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerri masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Qarkores Buxhetore në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimeve të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në Vushtrri në mbledhjen e mbajtur më **28.06.2012** mori këtë:

V E N D I M

Për ridestininimin e mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale

Neni 1

Me këtë vendim lejohet ridestininimi i mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale në programin e Drejtorisë për Arsim dhe në programin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 2

Mjetet e ridestinuara sipas nenit 1 të këtij vendimi barten pas realizimit të disa projekteve në investime kapitale, kurse për mjetet e mbetura dhe të lira nga këto projekte bëhet ridestininimi i tyre nga kategoria e investimeve kapitale për:

2.1 Drejtorinë e Arsimit (kodi 920, nënprogrami 93690 arsimi fillor, kodi i projektit 86200), ndërtimi i shkollës fillore në Zhilivodë, vlera e projektit 128,954.00€, dhe nga ky projekt bëhet ridestininimi i mjeteve në shumën prej 12,234.49 € për projektin e ri “Instalimi i ngrohjes në sh.f. Martiraj”.

2.2 Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis (kodi 660, nën programi planifikimi urban dhe inspeksioni), kodi 66425, nga ky nënprogram i projekteve kapitale bëhet ridestininimi i mjeteve si në vijim:

- Kodi i projektit 86160 asfaltimi i rrugës “Azem Galica”, vlera e projektit 120,000.00 €, ridestinohen mjetet e lira nga ky projekt në shumën prej 1,449.70 € në këto projekte:
- Kodi i projektit 86187 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Tërllabuq, shuma 1,154.00 €;
- Kodi i projektit 86170 Asfaltimi i rrugës Bukosh - Oblovik, shuma 218.30 €;
- Kodi i projektit 86178 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mavriq, shuma 77.40 €.

2.3 Kodi i projektit 86173 Asfaltimi i rrugës Bukosh-Liqej-Taraxhë, vlera e projektit 50,000.00 €, ridestinohen mjetet e lira nga ky projekt, në shumën prej 923.00 € në këto projekte:

- Kodi i projektit 86178 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mavriq, shuma 457.10 €;
- Kodi i projektit 86177 Asfaltimi i rrugëve në Sfaraçak (Xhafa-Menxhiqi), shuma 465.90 €.

2.4 Kodi i projektit 86164 Asfaltimi i rrugës “Lidhja e Lezhës” deri te përmendorja, vlera e projektit 50,000.00 €, ridestinohen mjetet e lira nga ky projekt në shumën prej 5,978.00 € në këto projekte:

- Kodi i projektit 86177 Asfaltimi i rrugëve në Sfaracak (Xhafa-Menxhiqi), shuma 4,450.10 €;
- Kodi i projektit 86179 Asfaltimi i rrugëve në Stanoc, shuma 1,527.90 €.

2.5 Kodi i projektit 86172 Asfaltimi i magjistrales-Novolan deri te shkolla, vlera e projektit 65,000.00 €, ridestinohen mjetet e lira nga ky projekt në shumën prej 112.40 € në këto projekte:

- Kodi i projektit 86179 Asfaltimi i rrugëve në Stanoc, shuma 112.40 €.

2.6 Kodi i projektit 86168 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zhilivodë, vlera e projektit 50.000.00 €, ridestinohen mjetet e lira nga ky projekt në shumën prej 2,625.00 € në këto projekte:

- Kodi i projektit 86179 Asfaltimi i rrugëve në Stanoc, shuma 1,290.35 €;
- Kodi i projektit 86185 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Beçiq, shuma 1,334.65 €.

2.7 Kodi i projektit 86175 Asfaltimi i rrugëve Karaçë-Gumnishtë, vlera e projektit 50.000.00 €, ridestinohen mjetet e lira nga ky projekt në shumën prej 2,952.95 € në këto projekte:

- Kodi i projektit 86185 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Beçiq, shuma 3,115.60€;
- Kodi i projektit 86186 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Duboc, shuma 4,225.00€;
- Kodi i projektit Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë e Epërme, shuma 5,612.35€.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 “e” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 “1” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në Vushtrri në mbledhjen e mbajtur më **28.06.2012** mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit për plotësimin e Draft-rregullores për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit

Neni 1

Me këtë vendim emërohet komisioni për plotësimin e Draft-rregullores për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit, në këtë përbërje:

- 1.1 Ferit Idrizi, PDK;
- 1.2 Melihate Basholli, PDK;
- 1.3 Veli Karaça, LDK;
- 1.4 Bahrije Pllana, AAK;
- 1.5 Qamil Sahiti, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 2

Komisioni ka për detyrë që të plotësojë dhe ndryshojë Draft-rregulloren për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit në Komunën e Vushtrrisë, dhe të procedoj për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e KPF-së dhe të kuvendit të muajit korrik 2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: komisioni në fjalë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 17 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në Vushtrri në mbledhjen e mbajtur më **28.06.2012** mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për Aftësim Profesional në fshatin Maxhunaj

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Qendrës për Aftësim Profesional në fshatin Maxhunaj, në ngastrën kadastrale nr. 504, e cila gjendet në oborrin e shkollës fillore “Rilindja” në fsh. Maxhunaj, në sipërfaqe prej 0,25.00 ha, pjesë nga sipërfaqja e përgjithshme 2.41.45 ha, fleta poseduese UL-70202046-00154, ZK Maxhunaj, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Vushtrri.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Bazuar në nenin 17 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në Vushtri në mbledhjen e mbajtur më **28.06.2012** mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes së Fëmijëve parashkollor (multietnik) në fshatin Gracë

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Çerdhes së Fëmijëve parashkollor (multietnik), e cila do të ndërtohet në fshatin Gracë, në ngastrën kadastrale nr. 512-1, në sipërfaqe prej 0,15.00 ha, pjesë nga sipërfaqja e përgjithshme 5.36.93 ha, fleta poseduese UL-702022-N-00001, ZK Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Vushtri.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa